

INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE I STANDARDEVE

PROGRAMI I GJUHËS ANGLEZE

KLASA VI

Tiranë, 2005

HYRJE

Gjuha angleze në këtë nivel të arsimit të detyruar shërben si baza për formimin e përgjithshëm të nxënësit nga ana gjuhësore, kulturore dhe intelektuale. Në klasën e gjashtë gjuha angleze zhvillohet me dy orë mësimi në javë, pra kemi:

35 javë mësimi me 2 orë mësimi në javë 70 orë mësimi vjetore

Në program janë paraparë vetëm drejtimet e punës në lëndën e gjuhës angleze, si dhe përmbajtja tërësore e nivelit dhe e sasisë së njohurive. Mbështetur në tekstin e mësimi, vetë mësuesi bën shpërndarjen e orëve sipas grup-temave, si dhe përcaktimin e temave për çdo orë mësimi.

Nëpërmjet këtij programi përforcohet dhe thellohet ajo çka është mësuar në klasat e mëparshme të ciklit të ulët të arsimit të detyruar, shtohen mundësitë që nxënësit të shprehin më mirë atë çka kanë mësuar duke përdorur të katra aftësitë gjuhësore, hapen hapësira të reja për t'u përballuar me shkëmbinet në gjuhën e huaj, si edhe me një zhvillim më të lartë intelektual.

Të mësuarit e gjuhës angleze në këtë nivel shkollimi u shërben nxënësve si një mënyrë për të mësuar dhe për të respektuar të tjerët, si edhe për të qenë tolerantë ndaj mendimeve dhe kulturave të vëndeve anglofolëse. Njohuritë e gjuhës angleze rriten në mënyrë spirale, duke rimarrë e duke përsëritur njohuritë që janë zhvilluar në ciklet e mëparshme, si dhe duke marrë njohuri të reja në mënyrë të përshkallëzuar.

Gjithashtu, synimet dhe objektivat e parshtruar në programin e klasës së gjashtë janë vazhdim i gjithë veprimtarisë së programuar për klasat pararendëse, duke i rishikuar ato në shërbim të moshës e të shkollës së formimit që kanë arritur nxënësit.

Ky program mban parasysh si grup-moshën e nxënësve, ashtu dhe karakteristikat e tyre përkatëse. Në të pëfshihen tema, objektiva, akte dhe funksione komunikative që lidhen me interesat e tyre moshore, si dhe u nxitin interesin e u zgjojnë kureshtjen e tyre

SYNIMET EDUKATIVE DHE OBJEKTIVA DIDAKTIKË

Mësimi i gjuhës angleze edhe në këtë nivel shkollimi synon të rritë mundësitë që u jep shkolla nxënësve për zhvillimin e kompetencave gjuhësore, ndergjegjësimimin e tyre ndaj kulturave të tjera.

Duke pasur parasysh se edhe gjuha e huaj është :

-mjet i të menduarit (që do të thotë mjet për kryerjen e një serë operacioneve mendore);

-mjet për të vendosur marrëdhënie shoqërore;

-mjet i shprehjes së mendimeve, ndjenjave dhe gjendjes shpirtërore;

-mjet për shprehjen e kulturës (duke kuptuar edhe konceptin historik, shoqëror e mjedisor), pëvetësimi i gjuhëve të huaja në përgjithësi dhe i gjuhës angleze në veçanti ndihmon në nxitjen e përgjegjësive të nxënësve dhe mësuesve për t'iu përgjigjur kërkesave për të qenë qytetarë evropianë me të gjitha të drejtat.

Synimet edukative

Të mësuarit e gjuhës angleze, si gjuha e huaj më me peshë në arsimin e mesëm të ulët, ka këto synime edukative:

*Të zhvillojë aftësitë gjuhësore të nxënësve me qëllim formimin e përgjithshëm të tyre, si dhe të përdorë gjuhën për qëllime praktike, duke u mbështetur në modele të të sjellurit në situata të caktuara mësimore.

*T'i familjarizojë nxënësit me praktikat kulturore të vendeve anglishtfolëse, si dhe t'u mundësojë zgjerimin e aftësive formuese, kulturore dhe njohëse të personalitetit, duke ndikuar drejtpërdrejt në formimin e tyre socialkulturore.

*T'i mundësojë nxënësit të ndërtojnë punën në mënyrë të pavaruar, si dhe të përdorin strategji të të mësuarit për t'i bërë ata sa më krijues.

*T'i aftësojë nxënësit të përdorin teknika për të punuar dhe për të bashkëvepruar.

Objektiva didaktikë

Të mësuarit e gjuhës angleze në këtë nivel shkollor bazohet mbi këto objektiva didaktikë të të mësuarit:

1. Vendosja e nxënësit në qendër të vëmendjes

Nxënësi mëson më mirë atëherë kur njohuritë e reja lidhen drejtpërdrejt me ta, me jetën dhe përvojat e tyre jetësore. Prandaj ky program mbështetet te niveli i nxënësve, njohuritë që kanë, aftësitë e grup-moshës, interesat, prirjet dhe përvojat e jetës vetjake.

2. Krijimi i mjedisit të të nxënit

Duke synuar të mësuarit me rendiment, në klasën e gjashtë nxënësit t'i krijohet një mjedis fizik, emocional e shkollor sfidues dhe jofrenues për proesin mësimor, një mjedis në të cilin të ndjehet i sigurt. Kjo arrihet kur menaxhimi dhe organizimi i veprimtarive të të nxënit që zhvillohen gjatë mësimin, shërbejnë për të ruajtur vëmendjen, interesin dhe përfshirjen e nxënësve në mësim.

3. Organizimin e klasës

Organizimi i klasës për mësimin e gjuhës angleze të jetë i zhdërvjelltë, që të mundësojë punën në grupe, të sigurojë lirshmërinë e nxënësve për të kuptuar qëllimin që paraqet çdo temë, mundësitë apo lehtësitë që afrohen për të eksploruar në gjuhën angleze, për të eksperimentuar në të, për ta përdorur atë në përputhje me nevojat e tij. Atmosfera e klasës të shërbejë si mbështetje dhe respekt për përgjigjen e nxënësit si nga mësuesi, ashtu edhe nga nxënësit e tjerë. Në këtë mënyrë do të arrihet që nxënësi ndërkohë mëson edhe nga shokët e tij. Herë pas here nxënësi punon në mënyrë të pavarur, duke menduar vetë për zgjidhjen e një problemi. Kështu, në secilën orë mësimi mësuesi të përdorë mënyra të ndryshme të organizimit të klasës për të krijuar e për të ruajtur një mjedis mbështetës për motivimin e nxënësve.

4. Të mësuarit në bashkëveprues

Rrjedhshmëria në të folur varet nga bashkëveprimi i gjerë social. Prandaj nxënësit gjatë orëve të gjuhës së huaj shpesh të punojnë së bashku. Detyrat e përbashkëta u japin nxënësve më shumë kohë për të folur me njëri-tjetrin e për të zhvilluar tek ta shkathtësi sociale. Njëherazi edhe shkalla e zotërimit të gjuhës rritet. Puna në grupe ka edhe disa përparësi të tjera si:

a) ndihmon në shoqërimin e nxënësve dhe i bën ata bashkëvruar me njëri-tjetrin dhe me mësuesit;

b) nxit të qenit tolerant ndaj mendimit të tjetrit;

c) inicion në përdorimin e formave demokratike për të ndarë përgjegjësitë dhe punën.

5. Përdorimi i gjuhës në klasë

Gjuha mbizotëruese gjatë orës së mësimi të jetë gjuha angleze. Mësuesi të jetë nxitësi dhe mbështetësi kryesor i përdorimit të gjuhës angleze në klasë, duke mënjanuar sa të jetë e mundur përdorimin e gjuhës amtare.

6. Të mësuarit e gramatikës

Nevojat e veçanta për komunikim mbështeten edhe në fitimin e njohurive të domosdoshme nga gramatika. Nxënësit marrin njohuri gramatikore në shërbim të rritjes së aftësisë komunikuese. Në këtë nivel janë parashikuar një sasi e vogël rregullash gramatikore për t'u mësuar, gjithmonë në mënyrë të tillë që nxënësit të mund të përdorin format gramatikore për qëllime komunikimi. Të mbahet parasysh se ato jepen dhe mësohen në mënyrë induktive. Nxënësit njihen e familjarizohen me dukurinë e re gramatikore në materiale autentike gjatë të gjithë procesit të nxënies.

7. Qortimi i gabimeve

Gabimet që nxënësi bën gjatë të shprehurit, qortohen në kohën dhe vëndin e duhur. Vërejtjet, shpjegimet dhe qortimet e mësuesit, të shokëve ose dhe të vetë nxënësit ndihmojnë për të nxitur vetëbesimin dhe vërtetërespektin gjatë procesit të mësimdhënies e mësimnxënies. Por asnjëherë qortimi të mos shndërrohet si qëllim në vetvete në klasë, pasi një veprim i tillë mund të çojë në frenimin e nisëativave të nxënësve, në heqjen e dëshirës së tyre për të folur, dëmton motivimin dhe mund të rrezikojë edhe ecurinë e mëtejshme të mësimi. Mësuesi ndërhyt me takt, duke përdorur forma të larmishme qortimi më shpesh kur nxënësit praktikojnë strukturat gramatikore dhe më rrallë kur nxënësit janë duke punuar në grup, janë duke debatuar apo duke diskutuar për tema të ndryshme.

8. Vazhdimësia dhe rimarrja

Një program me vlerë njeh rolin e vazhdimësisë dhe të rimarrjes gjatë të mësuarit. Përparimi kalon nga e thjeshta në të vështirën, nga konkretja në abstrakte. Studimet dhe eksperimentimet kanë provur se zakonisht një nxënës ka nevoje të ekspozohet ndaj elementeve të reja të gjuhës shtatë herë, në shtatë kontekste të ndryshme përpara se t'i pëvetësojë ato. Pra rimarrja e njohurive është e domosdoshme në gjuhën e huaj.

VLERËSIMI

Mësuesi përcakton standarde të pritshme për të gjithë nxënësit pavarësisht nga ndryshimet ndërmjet tyre nga ana emotive, kulturore dhe gjuhësore.

Vlerësimi bëhet në mënyrë sistematike dhe ndërthuret gjatë të gjithë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Mësuesit realizojnë ballafaqimin e nivelit të përparimit individual e kolektiv duke mbledhur vazhdimisht informacion për zhvillimin dhe asimilimin e njohurive dhe të aftësive. Ata shënojnë dhe vlerësojnë përparimin sistematik të nxënësve nëpërmjet vëzhgimeve, pyetjeve, testeve, detyrave me shkrim në shtëpi e klasë dhe sigurohen nëse nxënësit vazhdojnë të bëjnë përparime të dukshme në përvetësimin e dijeve, shprehive të të kuptuarit dhe të të shprehurit.

Mësuesit monitorojnë dhe qortojnë detyrat duke përcaktuar objektiva të qartë. Ata, nëpërmjet formave të ndryshme të vlerësimit sigurohen që nxënësit të përfitojnë dhe të konsolidojnë njohuritë, aftësitë dhe të kuptuarit e të shprehurit për njohuritë e përfshira në këtë program.

Format e ndryshme e të larmishme të vlerësimit u krijojnë mundësi nxënësve për të konsoliduar njohuritë e tyre si në klasë, ashtu edhe në shtëpi. Kjo arrihet duke u dhënë detyra të studiuara specifike me objektiva të qartë që përforcojnë dhe çojnë më tej njohuritë e fituara. Gjatë gjithë punës mësuesi u kushton vëmendje gabimeve dhe ndihmon në qrtiin e tyre.

Kontrolli gojor, megjithë araktetin e vetë subjektiv, betet një element i rëndësishëm i vlerësimit të arritjeve. Kontrolli periodik me shkrim na jep një informacion më të plotë për arritjet e nxënësit. Po kështu, edhe testet diagnostikuese të arritjeve të progresit e të përcaktimit të niveleve, kuizet të jenë realiste me objektiva të qartë e të matshëm.

Për të realizuar një vlerësim sa më objektiv dhe motivues, mund të përdoren tipat e mëposhtëm të ushtrimeve:

Përsëritje, dialogje të drejtuara dhe të hapura, intervista, stimulime, plotësime, pyetje të tipit e saktë apo e gabuar, pyetje të hapura, pyetje alternative, plotësime hartash, rrjeta semantike, diktime, riformulime fjalish, plotësim fjalish, letra zëvendësime fjalësh, ndërtim fjalish, qortime gabimesh etj.

Mësuesi njëherazi i përdor këto vlerësime për të përmirësuar anë të ndryshme të punës së tij, shikon në mënyrë kritikë metodat e tij të mësimdhënies dhe mban qëndrim po në mënyrë kritike për të përmirësuar frytshmërinë e tyre.

VETËVLERËSIMI

Vetëvlerësimi është element i rëndësishëm në mësimin e gjuhës angleze. Nxënësit vlerësojnë nga ana tyre zotërimin e objektivave dhe të standardeve të përshkruara në kurrikul. Vënia e synimeve të qarta në program mundëson vetëvlerësimin progresiv të tyre.

Rëndësia e vetëvlerësimit nxit të mësuarit e pavarur gjatë gjithë jetës. Nga vetëvlerësimi përfiton si nxënësi, ashtu edhe mësuesi. Njohja e nxënësit me vetëvlerësimin i ndërgegjëson ata të kuptojnë më mirë problemet e të mësuarit;

Por, vetëvlerësimi mund të konsiderohet edhe si aspekt problematik që shtron pyetje të tilla, si: “Si është e mundur që nxënësit të vlerësojnë vetveten?”, “A kanë njohuri të mjaftueshme?”, “A mund të jenë objektivë?”, “A mund të jetë vetëvlerësimi i besueshëm?” etj. Theksohen të gjitha këto për vetë faktin se vetëvlerësimi në lëndën e gjuhës së huaj nuk ka qenë pjesë e traditës sonë arsimore.

Vetëvlerësimi është i rëndësishëm edhe sepse lidhet me forma të tjera të vlerësimit dhe varet nga marrëdhëniet e drejta që vendosen ndërmjet tyre, në të cilat subjekt është vetë nxënësi.

Në procesin e mësimit të gjuhëve të huaja vetëvlerësimi mund të përqendrohet në tri aspekte kryesore:

1. Në procesin e mësimit, që nënkupton vlerësimin i progresit të nxënësve, nivelin e arritur në secilin shkallë dhe suksesin ose mosesuksesin në realizimin e detyrave dhe të objektivave të caktuar.
2. Në aftësitë e tyre komunikuese.
3. Në zotërimin e gjuhës, pra në numrin e fjalëve që di, strukturat gjuhësore dhe mënyrën si artikulon gjuhën.

PËRSHKRIMI I NIVELEVE TË KATËR AFTËSIVE GJUHËSORE

Përshkrimi i niveleve të katër aftësive gjuhësore jepet veçmas për secilën aftësi. Ato integrohen në orën e mësimit, gjatë të gjithë procesit mësimor. Përshkrimi i niveleve nuk mund të merret i veçuar. Ai gjen trajtim në kuadrin e përshkrimit të niveleve të arritura deri në fund të klasës së pestë. Mësuesi mbështetet në përshkrimin

e këtyre niveleve për të ndërtuar strategjitë dhe dhe teknikat e vlerësimit si të nxënësit, ashtu edhe të vetat. Njëherazi ai i përdor ato për të përcaktuar shkallën e përparimit, të përvetësimit dhe të arritjeve të nxënësve.

Në fund të klasës së gjashtë nxënësit:

- U përgjigjen pyetjeve të bëra dhe formojnë fjali dëftore dhe urdhërore të thjeshta, të tilla si: përshëndetje, paraqitje, leje etj.
- Shprehin qëndrimet e tyre, reagimet, sjelljet duke përdorur shprehje të shkurtra dhe të thjeshta.
- Shprehin pëlqimin a mospëlqimin për diçka.
- Përshkruajë njerëzit, vendet, sendet, ngjarjet duke përdorur shprehje të ngulitura të shkurtra.
- Marrin dhe japin informacion për tema të njohura.
- Shprehin nevojat e tyre vetjake më elementare
- Në aspektin gjuhësor bëjnë dallimin ndërmjet pjesëve kryesore të ligjëratës, si dhe zotërojnë fjalorin bazë.

PËRSHKRIMI I NIVELIT PËR DËGJIMIN

1. Nxënësi kupton urdhrat dhe reagon ndaj tyre.
2. Nxënësi kupton fraza, fjali dhe shprehje që lidhen me fushat e interesit të tij, informacione për veten, familjen, shkollën, vendbanimin, klasën dhe shkollën.
3. Nxënësi tregon se kupton dhe reagon ndaj dialogjeve dhe mesazheve të reja të shprehura në një gjuhë të thjeshtë dhe kryesisht çështje kryesore dhe hollësi të rëndësishme.
4. Nxënësi tregon se me anë të përsëritjes, gjesteve dhe elementeve të tjera vizuale kupton rrëfime dhe përshkrime të njohura të shprehura me një gjuhë të thjeshtë, të qartë dhe me ritëm normal.
5. Nxënësi kap thelbin në mesazhe, lajme të shkurtra, të thjeshta në radio, televizion, kur ai shoqërohet me komente të shkurtra ose figura.

PËRSHKRIMI I NIVELIT PËR TË FOLURIT

1. Nxënësi përgjigjet me shqiptim të qartë e të kuptueshëm duke përdorur struktura dhe fjalor të thjeshtë të përdorimit të përditshëm e të mësuara më përpara.
2. Nxënësi merr pjesë në dialogje me pyetje të thjeshta dhe përgjigje të shkurtra për atë çka përjeton duke shprehur ndjenjat , dëshirat apo parapëlqimet e tij.
3. Nxënësi merr pjesë në skenare të shkurtër të parapërgatitur që bazohen në bashkëbisedime të ndërtuara me fraza të ngulitura më parë që përdoren për të kërkuar dhe përcjellë informacione për situata të kaluara, aktuale ose të ardhshme.
4. Nxënësi përshkruan thjesht me shqiptim të saktë, leksik dhe struktura të njohura dhe korrekte, persona, objekte si edhe veprimtari të tij të përditshme.
5. Nxënësi u përgjigjet thjesht dhe shkurt pyetjeve që kanë lidhje me tekste të lexuara apo të dëgjuara në procesin mësimor.

PËRSHKRIMI I NIVELIT PËR LEXIMIN

1. Nxënësi lexon me zë të lartë, shqiptim të drejtë dhe nivel të pranueshëm tekste të njohura dhe të përshtatshme për nivelin dhe moshën, si edhe kupton dialogje të shkurtra rreth temave që i interesojnë.
2. Nxënësi lexon dhe kupton tregime të shkurtra rreth temave të njohura nëse janë shkruar në gjuhë të thjeshtë.

3. Nxënësi lexon dhe kupton tekste të shkurtra, të thjeshta me fjalor shumë të përdorshëm si: menu, reklama, njoftime, orare dhe nxjerr informacionin që dëshiron.

4. Nxënësi lexon dhe kupton një letër të thjeshta, një mesazh apo një korrespondencë ku bëhet fjalë për tema, veprimtari dhe aspekte të ndryshme të jetës së përditshme.

5. Nxënësi lexon dhe kupton mesazhe të thjeshta në kompjuter.

6. Nxënësi, duke u hedhur një vështrim gazetave, rubrikave dhe reklamave, gjen rubrikën që i intereson dhe veçon atë pjesë të informacionit që ka të bëjë me çmimin, përmasat dhe vendndodhjen e tyre.

PËRSHKRIMI I NIVELIT PËR TË SHKRUARIT

1. Nxënësi shkruan, me të diktuar ose jo, me saktësi fraza të ngulitura për tema të njohura.

2. Nxënësi ndërton me gjuhë të thjeshtë përshkruese fjali të shkurtra ku shpreh ndjenjat dhe reagimet vetjake për jetën e tij të përditshme, shkollën, familjen, hobet e të tjera.

3. Nxënësi ndërton fjali pyetëse dhe plotëson pyetësorë me të dhëna për veten ose shokun.

4. Nxënësi shkruan sipas një formati të caktuar letra, mesazhe, kartolina të shkurtra me shprehje të thjeshta përshëndetjeje për të pyetur, për të falenderuar ose refuzuar dikë.

5. Nxënësi shkruan me një leksik të mjaftueshëm për të shprehur nevoja të thjeshta dhe të domosdoshme.

6. Nxënësi shkruan paragrafë të shkurtër për të shprehur mendimin e tij në lidhje me temat e trajtuara në mësim.

7. Nxënësi shkruan duke respektuar treguesit e jashtëm të shkrimit, si: shkronjat e mësha, pragrafin, datën, titullin, shenjat e pikësimit etj.

ASPEKTE FONETIKE

Vëmendje e veçantë në këtë nivel të mësimin të gjuhës angleze I kushtohet aspektit fonetik e fonologjik, I cili përfshin njohjen dhe aftësinë për të perceptuar dhe për të realizuar shqiptim dhe theks të saktë të fjalës, ritëm e intonacion të duhur në situatë të dhëna.

Fonetika në këtë nivel trajton aspektet e mëposhtme:

1. Intonacionin normal (neutral)

Fjali deklarative pohore dhe mohore

Dad's working

The book isn't expensive

Fjali pyetëse që fillojnë me përemra pyetës: Who, what, where, which, why

Where are you going?

Fjali urdhërore:

Put your book on the table!

Fjali që shprehin mirësjellje:

Thank you.

2. Intonacioni ngritës

Fjali pyetëse të përgjithshme:

Can I see him?

Fjali që përmbajnë numërim sendesh, idesh etj.:

There are chairs, desks, benches, pictures in the class.

Fjali për të shprehur kërkesa, lutje:
Open the window, please.

3. Theksi i fjalës

Fjalë me theksin në rrokjen e parë:
Different, difficult, comfortable.

Fjalë me theksin në rrokjen e dytë:
Myself, yourself, become

Fjalë me theksin në rrokjen e tretë:
Understand.

Fjalë të përbëra:
Grandfather, footballground.

4. Theksi i fjalisë

Theksi bie në fjalët që bartin kuptim:
Come for tea; What is it about; she can; come and play.

5. Format e shkurtuara:

I'm ready, I've got, you'll do it, I can't.

6. Fonemat:

a) shqiptimi i s në shumësin e emrave dhe në vetën e tretë, koha e tashme e foljeve (s, z, iz)

b) Shqiptimi i d në kohën e shkuar të foljeve të rregullta (t, d, id).

FJALORI

Programi për klasën e gjashtë parashikon një fjalor aktiv prej rreth 550 njësisish leksikore. Nxënësit tashmë kanë përvetësuar një fjalor bazë dhe mund të njohin dhe të dallojnë fjalë që u përkasin familjeve semantike që lidhen me temat e dhëna. Ata duhet të përdorin fjalorin e mësuar në klasat III-V dhe ta plotësojnë atë me fjalët e reja.

Leksiku që parashikohet në këtë program, është i lidhur me aspektet pedagogjike të mësimdhënies, me aspektet gramatikore, si edhe me tema të tilla, si: llojet e ushqimeve, sportet, hobet, interesat, kohën, shkollën, veshjet, festat, përshkrimin fizik, përshkrimin e vendeve të ndryshme, blerjet, programet televizive, letrat, katolinat etj.

Zgjidhjen fjalë kyçe të lidhura me tematikën e dhënë për të mundësuar realizimin e komunikimit në përputhje me nevojat e nxënësve.

Ndiqen parimet statistikore në lidhje me leksikun duke zgjedhur fjalë me përdorim të lartë.

Zhvillimi i fjalorit nuk planifikohet paraprakisht për të mundësuar zhvillimin në mënyrë organike në përputhje me kërkesat e nxënësit kur ata përfshihen e aktivizohen në veprimtari komunikuese.

TOPICS

1. EVERY DAY LIFE

Eating, cooking customs (in Albania and around the world);

Sports (kinds of sports, personal preferences);

Free time, hobbies, interests;

Telling the time.

2. SCHOOL LIFE

A school day\ school timetable;

The rules and language of the classroom (identification of activities, reading, writing);

Mathematics: arithmetic (division, multiplication).

3. PERSONAL AND SCHOOL LIFE

Health problems, injuries and illnesses;

Clothes;

Celebrations in Albania and other countries;

Physical characteristics of the people (long hair, brown eyes etc).

4. THE WORLD AROUND US

Travel\ geography;

Famous places, buildings and places around the world;

Directions (north, south, go straight\right, left etc);

Money and shopping;

My House (and houses round the world).

5. THE WORLD OF COMMUNICATION

TV programs, cartoons and films;

Radio programs;

Letters and postcards.

COMMUNICATIVE ACTS / FUNCTIONS

Suggesting.

You should.....

What about.....

Lets play, go.....

Expressing intention and wish:

I would like.....

I'd like.....

Describing a person , place or building.

He looks like.....,

he's very tall, she has short hair, she has got short hair

Asking for and giving directions

Where is the bank? Go two blocks. It's on the left

Hoë far is the station? Hoë long does it take?

Talking about shopping.

How much is this? Hoë much does it cost? It's 200 leks.

Agreeing and disagreeing

Yes, you are right. I agree. No, I don't think so. I disagree.

Expressing appreciation

What a beautiful coat! How nice!

Asking for and giving information and showing preferences

What sports do you like?

What are your favourite foods?

What subject do you like?

Expressing feelings and reasons

I'm happy today because ...

I'm excited about...
I feel sad.....
Giving instructions and explanations
Turn right.
Go into the first building.
Cut the paper here.
Then fold it two times like this.
Giving advice
You should see the doctor
Take an aspirin
Requests and offers
Shall, will.

LANGUAGE STRUCTURES

Revision of grades 3, 4 and 5

Simple past (Continued, with some common irregular verbs)
came, went, did, ate, drank, saw, heard etc.

Past continuous

I was going to school when.....

Comparison of adjectives. (continued, longer adjectives, irregular forms)
more beautiful, more handsome, better, worse, farther etc.

Prepositions of location

Next to, across from, around, under, over, between etc.

Adverbs and adverbs of frequency in particular.

happily, carefully, quickly, never, sometimes, often, always etc
much, many, few, little

Pronouns

someone, somebody, something.

Anything, anyone, Nothing, no one.

Modals

Should and shouldn't (you should, shouldn't do it)

Have/ have got

I have got a big house

Idiomatic have

Have meals (have breakfast, lunch dinner.)

Have a walk, have a cold,

Have a headache, etc.

Let's, (let's go to the cinema)

Word order (subject, verb, object.)

Future with shall and will.

Plurals of irregular nouns.

Men, women, children, mice, feet etc.

Possessive of plural nouns

Pupil's books = the books of the pupil

Children's toys = the toys of the children.

Adjectives + preposition

Good at , interested in, afraid of.